



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Kërkesa e regjistruar sipas numrit 12-2503/1 të 16.07.2021. Refuzohet.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, organ tjetër është kompetent për të vepruar në lidhje me pretendimet në denoncimin e parashtruesit, në mënyrë që denoncimi të dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë për veprim kompetent.

Lënda me numër 12 -2503 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 12 - 2503 të datës 16.07.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. N; denoncim janë nxjerr; pohime për akuza korrupsioni nga një person zyrtar - /// i cili, sipas pretendimeve në denoncim, në periudhën 2018-2021 ka vepruar në mënyrë të paskrupullt dhe ka abuzuar me pozitën dhe autoritetin e tij zyrtar, në një mënyrë që ka ndikuar në ///, që ka vepruar pas një gjykimi të regjistruar nga një gjendje konflikti interesi, kështu që i njëjti gjykim ka përfunduar me shpallje të pafajësisë. Gjithashtu, thuhet se i lartpërmenduri /// nuk ka vepruar sipas ankesave të parashtruara nga parashtruesi, nuk ka ngritur procedurë për përgjegjësinë e gjyqarit të lartpërmendur të së njëjtës gjykatë, thuhet se ka pasur ndikim. mbi zyrtarët e punësuar në policinë gjyqësore dhe se nuk ka vepruar sipas indikacioneve të ///. U pretendua se parashtruesat në gjykatë ishin ndarë me dorë, pa mbajtur shënime të duhura për pranimin e saktë të parashtrësive në librin e brendshëm të dorëzimit të gjykatës dhe veprimet e tyre. Nga KSHPK kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në denoncim nuk u dorëzuan prova.

Pas studimit të pohimeve në denoncim, KSHPK konstatoi se në rastin konkret, parashtruesi shpreh pakënaqësi në mënyrën e organizimit dhe punës së gjykatës së mësipërme për rastet gjyqësore të treguara. KSHPK-ja konstaton se organi tjetër është kompetent për të vepruar në lidhje me pretendimet nga denoncimi i parashtruesit dhe do ta dorëzojë denoncimin në Ministrinë e Drejtësisë për veprim kompetent.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:

- Arkivi i KSHPK -së
- Parashtruesi

KOMISIONI SHITETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: K.N.

